

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "POWER WAVE" Sh.p.k.

Sot, më datë 17 / 03 / 2023,

- **"TLC GROUP" Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NUIS L61313021A, me seli në: Durrës, XHAFZOTAJ S.Z Xhavzotaj, Magazine Meshkurti, Autostrade, përfaqësuar nga Administratori i shoqërisë, Z. Shkëlzen Gega.
- **"SUN POWER" Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NUIS M21901025K, me seli në: Rruga Ismail Qemali, Pallati 11, Kati 2, ne krah te Radio Televizionit Shqiptar, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori i shoqërisë, Z. Evis Sopi.

Në përputhje me **Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"** (i ndryshuar) dhe **Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"**, kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "POWER WAVE" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "POWER WAVE" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Ismail Qemali", Pallati 11, Kati 2, në krah të Radio Televizionit Shqiptar, Tiranë.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA


Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese të energjisë elektrike solare (fotovoltaike) dhe energjisë së erës (eolike) në Republikën e Shqipërisë dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Ministrive e Institucioneve të Shtetit Shqiptar i të gjitha miratimeve, lejeve dhe licencave të cilat mundesojnë zhvillimin e këtij aktiviteti në menyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë.
- Projektim, zbatim, ndërtim të impianteve të prodhimit të energjisë me panele diellore;
- Shitja e energjisë elektrike për kliente të ndryshëm, shtet ose privat, të vendit ose të huaj;
- Shfrytëzim dhe mirëmbajtje të pajisjeve të paneleve diellore;
- Projektim, ndërtim dhe montim të pajisjeve dhe linjave të transmetimit të energjisë elektrike;



- Punime të ndryshme ndërtimore në funksion të objekteve dhe pajisjeve të gjenerimit dhe transmetimit të energjisë elektrike;
- Projektim dhe vlerësim gjeologjik, ambiental dhe tekniko-profesional në përgjithësi;
- Projektim, zbatim dhe ndërtim i objekteve civile dhe industriale;
- Punime ndërtimore të terreneve, kanalizimeve bonifikuese, të rrugëve dhe të tjera, pa çenuar objektin kryesor të shoqërisë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj në baze të autorizimeve dhe/ose lejeve perkatese të leshuara nga organet kompetente të fushës për qëllime investimesh në sektorin bujqësor/agrar/blegtori, ndërtim me qëllim komercial tregtar, residencial, etj, dhenie me qira/nenqira pronash/asete, menaxhim pronash, shitblerje real estate.
- Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin
- Shoqëria në objektin e aktivitetit të saj do të përfshijë dhe dhënie të konsulences financiare dhe të cdo lloj aktiviteti tjetër që lejohet sipas legjislacionit shqiptar.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakëve themelues në vlerën 1,000,000 Lekë (një milion) dhe është i përbërë nga 2 (dy) kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **TLC GROUP” Sh.p.k**, zotëron 1 kuotë, që perben 70% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 700,000 (shtatëqind mijë) Lekë dhe 700,000 (shtatëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.
- **“SUN POWER” Sh.p.k**, zotëron 1 kuotë, me 30% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 300,000 (treqind mijë) Lekë dhe 300,000 (treqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e statutit.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. **Z. Leart Spahija**, shtetas shqiptar, lindur më 08/02/1981, në Shkodër, banues në Tiranë, mbajtës i dokumentit Kartë Identiteti me nr. 035173386 dhe nr. personal I10208097N, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë, duke autorizuar **Administratorin Z. Leart Spahija** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

“TLC GROUP” Sh.p.k.

Përfaqësuar nga

Shkëlzen Gega

Shkëlzen Gega
SAG



“SUN POWER” Sh.p.k.

Përfaqësuar nga

Evis Sopi

Evis Sopi

A rectangular blue ink stamp for SUN POWER Sh.p.k. The stamp contains the text "SUN POWER" in large letters, "Sh.p.k." below it, and the identification number "NUIS : M 21901025 K" and "TIRANË - ALBANA" at the bottom.